



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:080145
Datë: 05.08.2024
Numri i dokumentit: 06019581

Kom.Dh.Shk.II.nr.822/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Dytë, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përbarimore të kreditorit Kosova Asphalt Sh.P.K., me seli në Ferizaj, e përfaqëson me autorizim Arlinda Haziri, avokat nga Prishtina, kundër debitorit J.D. B.I.- N.N. Globi Trans, me seli në Pejë, fshati Pavlan, në bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.55/24, të datës 09.02.2024, me datë 05.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kosova Asphalt Sh.P.K., me seli në Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.55/24, të datës 09.02.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.55/24, të datës 09.02.2024, në pikën I të dispozitivit, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit J.D. B.I.- N.N. Globi Trans, me seli në Pejë, i ushtruar kundër Urdhrit të Përbaruesit Privat Mubarak S. Shumolli P.nr.75/2021 të dt. 12.03.2021, dhe ka përfunduar përbarimi në këtë çështje përbarimore. Në pikën II të dispozitivit detyrohet kreditori Kosova Asphalt Sh.P.K., me seli në Ferizaj që tia paguaj shumën prej 208.00 euro në emër të përpilimi të prapësimit në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, dhe kjo çështje ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala debitorit.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kosova Asphalt Sh.P.K., me seli në Ferizaj, ka paraqitur propozim për përbarim, kundër debitorit J.D. B.I.- N.N. Globi Trans, me seli në Pejë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Fatura Nr.70/2018 e datës 15.08.2018 dhe Nr.74/2018 e datës 29.08.2018, në emër borxhit për shumën e mjeteve, në lartësi prej 10,734.57 euro, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shumën e përpilimi të prapësimi 208.00 euro sipas tarifës ligjore OAK-së.

Përbaruesi privat Mubarak S. Shumolli, duke vepruar në bazë të propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin P.nr.75/2021 të dt. 12.03.2021, ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori, ka ushtruar prapësim duke theksuar se pagesat ndaj kësaj kompanie tejkalojnë kontratën, pra janë paguar sipas kartelës financiare më shumë se sa borxhi që del nga marrëdhënia kontraktuale dhe se borxhi është kompozuar pas barazimit që është bërë duke ofruar shërbime të transportit nga dhënat e debitorit, andaj i propozon gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi dhe të anulohet urdhërin përbarimor.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim dhe se e kundërshton kërkesën e debitorit që të mos realizohet përbarimi duke theksuar se debitori nuk e ka dhënë asnjë arsye si ne kuptim të nenit 71 të LPP që të aprovohet prapësimi, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.55/24, të datës 09.02.2024, në pikën I të dispozitivit, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit J.D. B.I.- N.N. Globi Trans, me seli në Pejë, i ushtruar kundër Urdhrit të Përbaruesit Privat Mubarak S. Shumolli P.nr.75/2021 të dt. 12.03.2021, dhe ka përfunduar përbarimi në këtë çështje përbarimore. Në pikën II të dispozitivit detyrohet kreditori Kosova Asphalt Sh.P.K., me seli në Ferizaj që t'ia paguaj shumën prej 208.00 euro në emër të përpilimi të prapësimit në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës dhe nga vërejtjet nga aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Dhomave të Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr. 1246/23, ka gjetur se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me propozim për përbarim të dokumentit të besueshëm - Fatura Nr.70/2018 e datës 15.08.2018 dhe Nr.74/2018 e datës 29.08.2018, në emër borxhit për shumën e mjeteve, në lartësi prej 10,734.57 euro, mbi bazë të së cilës përbaruesi privat e ka lejuar përbarimin, por ky dokument nuk përbën bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par 1,

3 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument nuk e ka cilësinë e dokumentit përbarimor, e po ashtu nga shiqimin në këtë dokument rezulton se nuk përmban të gjitha elementet e kërkuar nga këto nene, të cilat janë përshkruar shërbimet, shumën e detyrimi dhe kohën e përmbushjes, mirëpo fatura nuk është pranuar nga debitorit në mënyrë të rregullt dhe është lëshuar në mënyrë të njëanshme. Andaj edhe mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar urdhrin përbarimor. Sa i përket shpenzimeve të procedurës përbarimore, gjykata ka vendosur sipas neneve 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke njohur shpenzimet e debitorit për përpilimin e prapësimi në shumë prej 208.00 sic është përcaktuar me rregullore për tarifa e avokatëve.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkalles se Dyte, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim, që është në përputhje me dispozitën nga neni 37 i Ligjit për Procedurën Përbarimore nr.04/L-139, ku Përcakton se, Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, pra dokumenti në fjalë fatura është dorëzuar në origjinal. Gjithashtu në bazë të dokumentit të besueshëm- Fatura Nr.70/2018 e datës 15.08.2018 dhe Nr.74/2018 e datës 29.08.2018, ku me dispozitën e nenit 29 par. 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Përbarimore nr.04/L-139, përcaktohet paragrafi 1 se Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm sipas LPP-së. Ndërsa sipas paragrafi 3 përcaktohet se, Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitorit si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin- fatura e cila nuk paraqet dokument të besueshëm, përkatësisht i njëjti nuk përmban të gjitha elementet të mjaftueshëm në kuptim të plotësisimit sipas neneve të lartëcekura nga LPP-ja. E po ashtu edhe gjykata e shkallës se dyte, pajtohet në tërësi me qëndrimin juridik të gjykatës se shkallës se parëse ky dokument përbën bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par. 1 dhe 3 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument nuk e ka cilësinë e dokumentit përbarimor dhe nuk është pranuar nga ana e debitorit në mënyrë të rregullt dhe mungon nënshkrimi apo pranimi nga ana e debitorit, gjithashtu me të drejtë gjykata shkallës së parë ka vendosur për shpenzimet që i takojnë debitorit në shumë prej 208.00 euro, bazuar në neneve 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së.

Kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga raporti detyrimor dhe se fatura në fjalë, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të papërshtatshme për përbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.822/2024, me datë 05.08.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami, d.v